



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 98/19 Prot

Tiranë, më 13/6 .2016

URDHËR

Nr. 150, datë 13/6 2016

Mbështetur në Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë Nr.52/2014, "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", dhe Nr.106/2014, "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të procesverbalit të hetimit administrativ, provave të administruara .Rekomandimit nr. 10, datë 09.05.2016, dhe mbi bazën e kërkesës së "LID" sh.p.k në ngarkim të kontrolluesit "**Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme**", Tiranë.

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 08, datë 28.01.2016 të Komisionerit, pranë kontrolluesit "**Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë**", është zhvilluar hetim administrativ me objekt:

- Verifikim të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, të kontratave paraprake të shitjeve të ankuesit G. R, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar;

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ pranë **Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë** pas verifikimit të aplikimit të regjistruar në sistemin elektronik të kontrolluesit dhe verifikimit të dosjes fizike të subjektit ndërtues (ankuesit) ka konstatuar se:

- Kontrolluesi ZVRPP Tiranë nuk mundi të vërtetojë se kush i ka depozituar në dosjen fizike të shoqërisë ndërtuese (ankuesi) kontratat paraprake të shitjes të cilat përmbajnë të dhëna personale të klientëve. Në këtë kuadër Zyra e Komisionerit vlerëson se kontrolluesi nuk ka respektuar rregullat për mbledhjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale gjatë administrimit dhe arkivimit të dokumenteve të pronësisë, në

kundërshtim me nenet 5/1/a, 6/1/a dhe 27 të Ligjit nr. 9887, dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar;

Në ngarkim të kontrolluesit “**Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme**”, Zyra e Komisionerit ka dalë me Rekomandimin nr. 10, datë 09.05.2016, nëpërmjet të cilit ndër të tjera është kërkuar që:

1. “Të tregohet kujdes lidhur me marrjen dhe provueshmërinë e pëlqimit të subjektit të të dhënave personale në rastet e depozitimit dhe mbledhjes së dokumenteve të pronësisë, në zbatim të nenit 6/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
2. Në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, duhet të hartohen rregulla mbi garantimin e sigurisë së të dhënave personale që përpunohen gjatë mbledhjes, mbajtjes dhe përhapjes, me qëllim lënien gjurmë të çdo veprimi që kryhet me të dhënat personale që administrohen nëpërmjet dokumenteve që përmban dosja e pronësisë.

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale që përpunohen në kuadër të regjistrimit të pasurive të paluajtshme nga institucioni publik i “**Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme**” dhe institucionet e tjera në nivel vendor që janë në varësi të saj, në kuadër të impaktit që ka mbi qytetarët shqiptarë që janë mbajtës të titujve të pronësisë (në cilësinë e subjekteve të të dhënave), pasojat pasurore që sjell ndaj tyre dhe rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave të tyre personale dhe privatësisë së tyre, me qëllim respektimin e detyrimeve ligjore përkatëse.

Neni 30, paragrafi 1, gërma “b” e ligjit të sipërcituar përcakton se: “Komisioneri ka këto të drejta: b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale”.

Sa më sipër, në zbatim të Rekomandimit nr. 10, datë 09.05.2016 të Zyrës së Komisionerit dhe neneve 19, 29, 30/1/b dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe nenit 72/3 të Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

URDHËROJ:

1. Kontrolluesi “**Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme**”, të realizojë në mënyrë të menjëhershme, bllokimin e përpunimit të të dhënave personale në 32 kontratat paraprake të shitjes të lidhura midis shoqërisë “LID” sh.p.k dhe personave të tretë të administruara nga ZVRPP Tiranë.

2. Kontrolluesi “Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të marrë masa për mundësinë e depozitimit të tyre në mënyrë të ligjshme sipas procedurave përkatëse ligjore dhe në rast mosdepozitimi në mënyrën e duhur të realizohet shkatërrimi i të dhënave personale në 32 kontratat paraprake të shitjes brenda 30 ditëve nga komunikimi.
3. Kontrolluesi “Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër.
4. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rëkomandimeve të tij, vendos sanksion administrativ me gjobë dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.
5. Kundër këtij Urdhëri mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga komunikimi i tij.

Ky urdhër u shpall sot më, 13/6/2016

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI